



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 38, datë 23 / 07 / 2026

Në mbështetje të nenit 54, germa "m", dhe Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Ligjin Nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", në Ligjin 8480, date 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", në Ligjin Nr. 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave për dhënien e medaljeve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë", në Kodin e Procedurave Administrative, në mbledhjen e radhës, Kryetari i Bashkisë Kavajë i kërkon Këshillit të Bashkisë Kavajë, i cili pasi shqyrtoi projekt vendimin:

VENDOSI

dhënien e titullit "QYTETAR NDERI" për Z. HASAN KORBI

Me motivacion

"Për kontributin e shkëlqyer dhënë në fushën e krijimtarisë si historian dhe poet, me krijimtari të jashtëzakonshme artistike, duke botuar libra me vlerë dhe plotësuar bukur një arkiv të vyer letrar e historik për qytetin, për vite dhe dekada. Artist me vlera të gjithëanëshme që ka promovuar, dokumentuar e ruajtur në kujtesën kolektive, emrin e qytetit të Kavajës në mbarë trojet shqiptare"

1. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës dhe Sporteve
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

RUDIN HYLVIU

Sekretari i Këshillit Bashkiak

MERI BITURKU

Miratuar me vota

Vota Pro

Vota Kunder

Vota Abstenim

Zbardhur me datë

22
22
—
—
24 / 07 / 2026

